DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-VI- Nr. Br. No. 0204-188/5
Data Datum Date 24.02.2014

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

Datë: 12.02.2014
Nr. 0204-188

**PËR:** **Rufki Suma,** Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
**Qamush Brava,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit

**LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË Hanit të Elezit**, të pranuar më datën 07.02.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit të miratuar me datën 31.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendimi për miratimin e planit të punës së kuvendit të komunës të Hanit të Elezit për vitin 2014.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së**

______________________________

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-VI- Nr. Br. No. 0204-188/5
Data Datum Date 24.02.2014

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 12.02.2014
br. 0204-188

**Za:** **Rufki Suma,** Gradonačelnik opštine Elez Han
**Qamush Brava,** Predsedavajući Skupštine opštine Elez Han

**Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Elez Han**
Primljeno dana 07.02.2014

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti definisano zakona o lokalnoj samopupravi , kao i prema uredbi br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarsva dodatak XII, nakon razmatranja odluke odobreno dana 31.01.2014 od strane Skupštine opštine Elez Han , POTVRĐUJE zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnpoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi:

- Odluka o usvajanju plana rada Skupštine opštine Elez Han za 2014.

Sa poštovanjem

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a*

**Republika e Kosovës / Republic of Kosova**
**Kuvendi i Komunës -Municipality Assambly**
**Hani i Elezit**

*01/ Nr.487 /2014*

**Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2014 miratoi:**

## VENDIMIN

### PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2014

I

Miratohet plani i punës së kuvendit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2014.

II

Kuvendit i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2014 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

| Mbledhja | Temat që do të diskutohen | Afati i realizimit |
|---|---|---|
| Mbledhja e (I) | • Miratimi i buxhetit për vitin 2014 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2015-2016 për komunën e Hanit të Elezit<br>• Themelimi i Komitetit për Politik dhe Financa.<br>• Themelimi i Komitetit për Komunitete.<br>• Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.<br>• Propozim vendim për caktimin e kritereve dhe shpalljen e konkursit për komitetet konsultative.<br>• Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2014<br>• Miratimi i planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2014 | Janar |
| Mbledhja e (II) | • Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2013<br>• Miratimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2013<br>• Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013.<br>• Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake komunale nga viti 2013 në vitin 2014 .<br>• Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2013-2014.<br>• Miratimi i planit rregullues. | Shkurt |
| Mbledhja e (III) | • Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2014.<br>• Miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete 2013.<br>• Miratimi i raportit të punës së tri Komiteteve Konsultative 2013.<br>• Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2013.<br>• Miratimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi<br>• Miratimi i emërtimit të rrugëve të vendbanimeve të Komunës së Hanit të Elezit.<br>• Shqyrtimi i Projekt rregullores për Taksa, tarifa dhe ngarkesa. | Mars |

| | | |
|---|---|---|
| Mbledhja e (IV) | • Miratimi i raportit tre mujorë të shpenzimeve buxhetore për vitin 2014<br>• Miratimi i Rregullores për Taksa, tarifa dhe ngarkesa.<br>• Shqyrtimi i Plotësim-ndryshimit të statutit të komunës.<br>• Shqyrtim i projekt rregullores për korrje shirje.<br>• Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit. | Prill |
| Mbledhja e (V) | • Rishikimi gjashtëmujor i buxhetit (RGJB) të komunës për vitin 2014<br>• Marrja e vendimit për ndarje të bursave për student.<br>• Miratimi i Plotësim-ndryshimit të statutit të komunës.<br>• Miratim i projekt rregullores për korrje shirje.<br>• Miratimi i planit të punës së tri Komiteteve Konsultative për vitin 2014. | Maj |
| Mbledhja e (VI) | • Korniza afatmesme e shpenzimeve të komunës së Hanit të Elezit për vitet 2015-17.<br>• Shqyrtim i plotësim ndryshim i rregullores për kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të SHFMU dhe SHML. | Qershor |
| Mbledhja e (VII) | • Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të punës së kryetarit të komunës për vitin 2013.<br>• Miratimi i raportit gjashtëmujor të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013.<br>• Shqyrtimi i rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2014 | Korrik |
| Mbledhja e (VIII) | • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2013-2014.<br>• Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2014. | Gusht |
| Mbledhja e (IX) | • Miratimi i Projekt-Buxheti për vitin 2015 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2016-17<br>• Miratimi i rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.<br>• Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2014/2015<br>• Raporti i Auditimit për vitin 2013. | Shtator |
| Mbledhja e (X) | • Raporti i DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2013/2014 në SHFMU dhe SHML<br>• Miratimi i raportit nëntëmujor të shpenzimeve buxhetore për vitin 2014.<br>• Shqyrtimi i projekt rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale.<br>• Shqyrtimi i projekt rregullores për rrugët lokale dhe rrugët në vendbanime. | Tetor |
| Mbledhja e (XI) | • Miratimi i plotësim ndryshmit të rregullores për kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të SHFMU dhe SHML.<br>• Miratimi i projekt rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale.<br>• Miratimi i projekt rregullores për rrugët lokale dhe rrugët në vendbanime. | Nëntor |
| Mbledhja e (XII) | • Miratimi i Plani të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2015.<br>• Miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2015. | Dhjetor |

## IV

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2014, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

## V

Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VI

Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.

VII

Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

VIII

Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën III të këtij Vendimi , është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

IX

Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2014, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2014.

X

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

XI

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.01.2014

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Qamush Brava**